



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

DREJTORIA E BUJQËSISË PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

PLANI I PUNËS PËR VITIN 2022

Stabiliteti afat gjatë ekonomik dhe shoqëror ne radhë të parë varet nga zhvillimi i qëndrueshëm i bujqësisë. Ky plan program ka për qëllim përmirësimin e sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural.

SYNIMET PROGRAMORE

Synimet kryesore në politikën agrare për vitin 2022 do të jenë:
Të kalohet nga prodhimtaria në ferma që plotësojnë nevojat e ekonomisë familjare në ferma gjysmë komerciale dhe komerciale.
Synim tjetër është edhe krijimi i urave bashkëpunuese me donator të ndryshëm me qëllim të krijimit dhe përmirësimit të jetës së qytetarëve.

PROJEKTET TË CILAT DO TE ZHVILLOHEN GJATË VITIT 2022

- 1. Projekti për fidane të mjedrave**
- 2. Projekt për bletari**
- 3. Projekti për serra**
- 4. Projekt për blegfori**
- 5. Projekti për penda – në proces**
- 6. Monitorimi i projekteve**

Realizimi i aktiviteteve përgjatë muajve

Gjatë muajve të vitit 2022 planifikohen të zhvillohen një vargë aktivitete me qëllim të përmirësimit të mirëqenies së qytetarëve të komunës së Podujeves.

Muaji Janar 2022 – Do të realizohen këto aktivitete:

Mbajtja e këshillimeve në lëmit e blegtorisë, perimkulturës, shpeztarisë etj. Qëllimi i këtyre këshillimeve është njohja më e mirë me mënyrën e kultivimit dhe rritjes së produktivitetit, mënyrën e ushqimit, higjienës dhe mbarështimit etj.

Muaji Shkurt 2022 – Do të realizohen këto aktivitete:

Mbajtja e këshillimeve dhe biseda me pemëtarët ku temat kryesore do të jenë: mirëmbajtja e pemishteve, krasitja, spërkatja dimërore, sëmundjet e ndryshme etj. Pra, kryesishtë do të zhvillohen aktivitete që kanë të bëjnë për përgatitje në pemishte

Muaji Mars 2022 – Do të realizohen këto aktivitete:

Këshillime me lavëtarët, perimtarët dhe blegtorët. Bisedat gjatë këtyre këshillimeve do të ishin përgatitja për mbjelljet pranverore riplehërimi i mbjelljeve vjeshtore përdorimi i sasisë së plehut dhe farës kalimi nga ushqimi i thatë (dimëror) në ushqim të gjelbër.

Bashkëpunimi me organizatat (barnatoret bujqësore) që e furnizojnë tregun me repromaterial.

Muaji Prill 2022 – Do të realizohen këto aktivitete:

Vizitë fermave me qëllim për grumbullimin dhe njohjen e gjendjes faktike të tyre.

Hartimi i raporteve dhe informatave për nevojat e komunës dhe Ministrinë e Bujqësisë.

Bashkëpunimi me OJQ-të e ndryshme me qëllim për investim në lëmin e Bujqësisë.

Organizimi i panairit të gjedhit me qëllime për njohjen e të arriturave në Komunën tone.

Realizimi i mbjelljeve pranverore.

Muaji Maj 2022 – Do te realizohen këto aktivitete:

Përgatitja për korrje-shirje

Hartimi i planit për korrje-shirje

Në bashkëpunim me MBPZHR dhe Fakultetin e Bujqësisë,
të mbahen ligjëratat dhe kontrollimi teknik i autokombajnave.

Muaji Qershor 2022 – Do te realizohen këto aktivitete:

Organizimi i vizitës së panairit në nivel të Republikës së Kosovës
që do të bëhet me fermer të zgjedhur.

Pjesëmarrja do të jetë edhe me raca të ndryshme të gjedheve të fermerëve
tanë.

Formimi i shtabit komunal për përcjelljen e korrje- shirjeve.

Muaji Korrik 2022 – Do te realizohen këto aktivitete:

Fillimi i korrje-shirjeve.

Përgatitja e informatave për ecurinë gjatë fushatës.

Muaji Gusht 2022 – Do te realizohen këto aktivitete:

Raporti përfundimtarë i korrje-shirjeve përzgjedhja e disa fermerëve më të
suksesshëm në rendimentet e arritura.

Këshillime rreth parapërgatitjes së tokës për mbjellje vjeshtore.

Muaji Shtator 2022 – Do te realizohen këto aktivitete:

Këshillimet në temat për mbjelljet vjeshtore.
Bashkëpunimi me organizatat (barnatore bujqësore) që të sigurojnë repromaterial (farë,pleh,mjete dezinfektuese) të cilat ju përshtatën kushteve tona .

Muaji Tetor 2022 – Do te realizohen këto aktivitete:

Mbjelljet vjeshtore dhe përcjellja e tyre.
Dhënia e këshillimeve të drejtpërdrejta etj.
Këshilla në pemëtari rreth mbjelljes së llojeve të ndryshme të pemëve.
Organizimi i panairit (Mjalti i Llapit).

Muaji Nëntor 2022 – Do te realizohen këto aktivitete:

Realizimi i mbjelljeve vjeshtore.
Këshillime me perimtarët që bëjnë kultivimin në serrë
Vizitë fshatrave dhe dhënia e këshillave për përmirësimin e jetës në fshat.
Organizimi i Darkës së lamës.

Muaji Dhjetor 2022 – Do te realizohen këto aktivitete:

Realizimi i planeve vjetore .
Zgjedhja e fermerëve më të mirë të vitit tashmë festë tradicionale.
Bashkëpunimi i mirë me MBPZHR , OJQ-te Fakultetin e bujqësisë etj.
Pjesëmarrja në seminare dhe takime të ndryshme.
Punë të përditshme në zyrë dhe punë tjera që janë në interes të Komunës.

PLANI I PUNËS PËR PYLLTARI 2022

Kemi për detyrë dhe obligim mbrojtjen e pyjeve nga aktivitete ilegale. Sektori i pylltarisë ka detyra permanente të cilat janë të parashikuara edhe me udhëzimet administrative nr: UA – 22/2007, UA – 05/2010, UA – 07/2010 dhe Ligjit nr. 03/L – 153 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/3 për pyjet e Kosovës.

Mbrojtjen e pyjeve dhe resurseve kombëtare nga shfrytëzimi ilegal

- Prerjet ilegale
- Zjarret dhe dëmtuesit me origjinë fitopatologjike dhe entomologjike
- Në prona private ruajtjen e pyjeve nga prerjet ilegale e bëjnë vetë pronarët e pyjeve private
- Rojet e pyjeve janë përgjegjëse për kafshët e egra në teritorin e caktuar
- Rojet e pyjeve janë përgjegjëse për kryerjen e procedurës së qarkullimit të masës drunore si në pronën private po ashtu edhe në pronën publike

Zbatimi i masave dhe planeve parandaluese nga

- Zjarret
- Kullotjet ilegale
- Nxjerrjen e gurëve
- Zhavorit
- Rërës
- Dheut
- Deponimin e mbeturinave

Veprimet që duhet të mirren në prona publike

- Rojet e pyjeve ushtrojnë fletëparaqitje për veprimet ilegale duke siguruar dëshmi nga vendi i ngjarjes dhe të njëjtat dërgohen në gjykatat kompetente
- Të organizohen kontrollat në rrugë pyjore dhe jo pyjore së bashku me organet e rendit dhe inspektoratin lidhur me kontrollën e qarkullimit të masës drunore, grumbullimit dhe përpunimit të saj në pika deponuese
- Të kryhen revizione të rregullta dhe të jashtëzakonshme varësisht nga nevoja apo kërkesa e organeve kompetente
- Të kryhet kontrolli i damkosjes, prerjes dhe transportit të asortimenteve pyjore
- Pyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura

Pranimi i dokumentacionit nga pronarët e pyjeve private për lëshimin e lejeve për prerje

Realizimi (kryerja) i konfiskimit të masës drunore që haset në transport pa dokumentacion përkatës (damkë, fletëpërcjellje) sistemimi i tyre në depo dhe kujdesi për to

Plani menaxhues i vitit 2022

Si pasojë e erërave të forta dhe borës së madhe në Janar të vitit 2021 kemi pas dëmtime të pishave në prona publike në ngastrën nr. 063 vendi i quajtur "Shakovicë" dhe ngastrën nr. 103 vendi i quajtur "Orllan".

Ngastra nr. 233/04 vendi i quajtur "Pakashticë e Poshtme" masa drunore është rrallim selektiv.

- Lidhur me shfrytëzimin e masës drunore nga pyjet publike punimet kanë mbetur të pa përfunduara për shkakë të kushteve klimatike.

Podujevë, Janar 2022

Drejtori i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

Fatmir Rudari



Fatmir Rudari